

Vendim nr. 243 datë 18.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 18.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (I) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: IRFAN SHURDHA

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-291 (46), datë 30.01.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 41, pika 1, 41, pika 2, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Irfan Shurdha është emëruar në detyrën drejtor i Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë (KVVTP) me urdhrin nr. 100, datë 13.10.2008 të prefektit të qarkut Elbasan. Më pas, në datën 01.04.2009 kërkuesi ka lidhur kontratë pune individuale për një afat të pacaktuar me prefektin e qarkut Elbasan.

2. Me urdhrin nr. 65, datë 20.05.2014 të prefektit të qarkut Elbasan, kërkuesit i është dhënë masa disiplinore me motivacionin “Moskryerje e detyrës funksionale dhe organizative si drejtor i KVVTP-së pranë institucionit të prefektit të qarkut Elbasan”, duke e liruar nga detyra dhe duke e emëruar anëtar të KVVTP-së, Elbasan.

3. Me urdhrin nr. 109, datë 06.10.2014, i cili ka hyrë në fuqi menjëherë, kërkuesit i është dhënë masa disiplinore “Pushim nga puna dhe zgjidhje e kontratës”, me motivacionin “Shkelje e rëndë e detyrës funksionale në mënyrë të përsëritur”.

4. Në datën 13.10.2014 kërkuesi ka paraqitur padi kundër prefektit të qarkut Elbasan, në të cilën ka kërkuar kthimin në pozicionin e mëparshëm të punës si anëtar i KVVTP-së, qarku Elbasan si pasojë e pavlefshmërisë së urdhrit nr. 109, datë 06.10.2014, pagesën e pagës për kohën e qëndrimit pa punë padrejhtësisht deri në ekzekutimin e vendimit të gjykatës, si dhe pezullimin e urdhrit nr. 109, datë 06.10.2014.

5. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. 1777, datë 22.12.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë me arsyetimin se për punonjësit e komisioneve vendore ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së punës nuk është ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (ligji nr. 152/2013), por ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (Kodi i Punës). Sipas saj, në asnjë rast kërkuesi nuk është në një pozicion pune që të përfitojë nga përmbajtja e nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, pasi nuk është i punësuar në ndonjë pozicion të shërbimit civil, por ka kryer një detyrë shtetërore, struktura e së cilës përjashtohet nga shërbimi civil dhe marrëdhënia e tij e punës rregullohet sipas Kodit të Punës. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

6. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 296, datë 01.02.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe pranimin e pjesshëm të padisë. Ajo gjykatë, sikurse dhe gjykata e shkallës së parë, ka mbajtur të njëjtin qëndrim në lidhje me ligjin e aplikueshëm,

Kodin e Punës. Ndërkohë, në analizë të akteve shkresore dhe pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, gjykata e apelit ka vlerësuar se zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi ka qenë e pajustificuar dhe e menjëhershme, për rrjedhojë ka përcaktuar detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë kërkuuesin me 20 paga, të llogaritura mbi bazën e pagës mujore bruto.

7. Mbi bazën e rekurseve të ushtruara nga palët ndërgjyqëse, si dhe të kundërrekursit të kërkuessit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-291 (46), datë 30.01.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ajo gjykatë edhe pse ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e gjykatave të faktit se marrëdhëniet e punës për punonjësit e komisioneve vendore rregullohen sipas Kodit të Punës, ka argumentuar se qëndrimi i mbajtur nga gjykata e apelit është i gabuar. Sipas saj, gjykata e apelit edhe pse ka arritur në përfundimin e drejtë se kërkuessi nuk e gëzon statusin e nëpunësit civil e për rrjedhojë kërkimet e tij në padi nuk gëzojnë mbrojtje ligjore, ajo nuk duhej të shprehej tej kërkimeve të ngritura në padi dhe në ankimin e kërkuessit, pasi janë pikërisht shkaqet e parashtruara në ankim që përcaktojnë kufijtë e shqyrtimit gjyqësor në shkallë të dytë.

8. Në datën 03.09.2024 kërkuessi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuessit

9. ***Kërkuessi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

9.1 *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspekt të:

9.1.1. *Së drejtës së aksesit në drejtim të së drejtës për t’u dëgjuar e gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj si dhe së drejtës për t’u mbrojtur*, pasi Kolegji

Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë zgjidhje ligjore pretendimeve të kërkuarit, duke mos e zgjidhur konfliktin midis tij dhe palës së paditur lidhur me themelin e pretendimeve të tij për largimin e padrejtë nga detyra, rrjedhimisht lidhur edhe me shpërblimet e mundshme për shkak të tij.

9.1.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit nuk ka parashtruar e nuk ka trajtuar me hollësi argumentet ligjore të kërkuarit, edhe pse ai ka ushtruar rekurs e kundërrekurs, duke u pajtuar pjesërisht me zgjidhjen e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit.

9.1.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (në dhomën e këshillimit) nuk ka respektuar nenin 17, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), sipas të cilit gjykata bën një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa u lidhur me përcaktimin që mund të propozojnë palët. Gjithashtu, është në kundërshtim edhe me vendimin unifikues nr. 3/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit gjykata e zbulon shkakun e padisë së paditësit duke e analizuar padinë në tërësinë e saj, jo duke u kufizuar te dispozitat ligjore të referuara nga paditësi në pjesën hyrëse të saj dhe duhet ta zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë.

9.1.4. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka kryer një analizë shteruese lidhur me nenin 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013 edhe pse ishte çështja kryesore e vendimmarrjes.

9.2 *Parimi i barazisë para ligjit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë qëllimisht e ka interpretuar nenin 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013 në mënyrë përjashtuese, kur ndërkohë dispozita ishte përfshirëse. Gjykata e Lartë nuk e ka përmbushur funksionin e zbatimit të saktë të dispozitave ligjore, por dhe të orientimit të gjykatave më të ulëta.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesit

10. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet gjyqësore të kundërshtuara prej tij, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Kolegji çmon se kërkuesi plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, pasi ai i është drejtuar Gjykatës pasi ka përfunduar shqyrtimi gjyqësor i çështjes së tij edhe në Gjykatën e Lartë, ndaj ai nuk ka mjet tjetër ligjor në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000.

13. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata ka pohuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Kolegji vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë që ka përmbyllur procesin gjyqësor mban datën 30.01.2024, ndërkohë që ankimi kushtetues është paraqitur prej kërkesit në datën 03.09.2024. Ndërkohë, nga aktet bashkëlidhur ankimit kushtetues, rezulton se Gjykata e Lartë në

datën 24.05.2024 ka informuar nëpërmjet postës elektronike përfaqësuesin ligjor të kërkuesit se vendimi është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 09.05.2024, që është edhe momenti kur palët mund ta dispononin këtë vendim. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se data nga fillon afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 09.05.2024, kur vendimi është bërë i disponueshëm për kërkuesin, ndaj ai legjitimohet edhe *ratione temporis*.

15. Për sa i përket legjitimitit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit në aspekt të së drejtës për t'u dëgjuar e gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe së drejtës për t'u mbrojtur, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, parimit të sigurisë juridike, të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe të parimit të barazisë para ligjit, të garantuara nga nenet 42, 142, pika 1 dhe 18 të Kushtetutës.

16. Për sa i takon pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, kërkuesi ka argumentuar se Gjykata e Lartë (në dhomën e këshillimit) nuk ka bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, si dhe nuk i ka analizuar në tërësi aktet e tij, gjë që bie në kundërshtim me nenin 17, pika 2, të ligjit nr. 49/2012 dhe vendimin unifikues nr. 3/2012. Po kështu, ai ka pretenduar se i është cenuar dhe barazia para ligjit, pasi, sipas tij, interpretimi i ligjit nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë është bërë qëllimisht në mënyrë përjashtuese, duke sjellë për pasojë cenimin e parimit të barazisë para ligjit. Mbështetur në thelbin e argumenteve të këtyre pretendimeve, Kolegji vëren se ato kanë të bëjnë me identifikimin nga gjykatat të kuadrit ligjor të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në të cilën është palë kërkuesi, i cili është atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndaj, për rrjedhojë, pretendimet për cenim të barazisë para ligjit dhe të sigurisë juridike nuk mund të merren në shqyrtim.

17. Lidhur me pretendimet për cenimin e së drejtës së aksesit në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar e gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, si dhe së drejtës për t'u mbrojtur, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, kërkuesi ka argumentuar se Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk ka marrë në shqyrtim as rekursin, as kundërrkursin, në të cilat ai ka parashtruar shkaqet për mosrespektimin e Kodit të Punës, duke mos i dhënë në këtë mënyrë mundësi të mbrohej nga rekursi abuziv i palës së paditur. Kolegji vëren se këto pretendime në thelb lidhen me argumentet e dhëna nga Gjykata e Lartë për

zgjidhjen e themelit të çështjes, ndaj çmon t'i analizojë ato në këndvështrim të arsytimit të vendimit, i cili *prima facie* hyn në juridiksionin e kësaj Gjykate.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

18. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit nuk ka marrë në shqyrtim kundërrekursin e kërkuesit, i cili parashtronte pretendimet lidhur me mosrespektimin e Kodit të Punës, duke i mohuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur nga rekursi abuziv i palës së paditur. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë, edhe pse ai ka ushtruar rekurs e kundërrekurs, duke u pajtuar pjesërisht me zgjidhjen e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, nuk ka parashtruar e nuk ka trajtuar me hollësi argumentet ligjore të tij. Po kështu, ai ka argumentuar se Gjykata e Lartë nuk e ka përmbushur funksionin e zbatimit të saktë të dispozitave ligjore, por edhe të orientimit të gjykatave më të ulëta, si dhe nuk ka kryer një analizë shteruese lidhur me nenin 67, pika 3, të ligjit 152/2013, edhe pse ishte çështja kryesore e vendimmarrjes.

19. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili në çdo rast, duhet të jetë logjik dhe në tërësinë e tij duhet konsideruar si një unitet, ku pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 12, datë 15.03.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Po kështu, Gjykata në mënyrë konstante ka pohuar se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 32, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga kërkuesi, i cili ka kërkuar kthimin në pozicionin e mëparshëm të punës dhe shpërblimet përkatëse. Pas rrëzimit të padisë nga gjykata e shkallës së parë dhe pranimit pjesërisht të saj nga gjykata e apelit, kërkuesi dhe pala e paditur i janë drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila, pasi ka shqyrtuar çështjen në themel, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ajo gjykatë ka vlerësuar se rekursi i palës së paditur përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012 për cenimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, duke arsyetuar se ai vendim është në një linjë të gabuar arsyetimi, që nuk përputhet me parashikimet e ligjit procedural. Sipas Gjykatës së Lartë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka zbatuar drejt ligjin material, si dhe ka respektuar dispozitat procedurale që lidhen me objektin e mosmarrëveshjes dhe detyrimin e asaj gjykate për t'u shprehur mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet. Ndërsa gjykata e apelit ka argumentuar se Gjykata e Lartë, edhe pse ka arritur në përfundimin e drejtë se kërkuesi nuk e gëzon statusin e nëpunësit civil e për rrjedhojë kërkimet e tij në padi nuk gëzojnë mbrojtje ligjore, nuk duhet të shprehej tej kërkimeve të ngritura në padi dhe në ankimin e kërkuesit, pasi janë pikërisht shkaqet e parashtruara në ankim që përcaktojnë kufijtë e shqyrtimit gjyqësor në shkallë të dytë. Ajo gjykatë, bazuar në pretendimet e kërkuesit të ngritura në rekurs e kundërrekurs, ka vlerësuar se Gjykata Administrative e Apelit ka interpretuar gabim përfundimet e vendimit unifikues nr. 3/2012, i cili nuk i jep në asnjë rast diskrecion gjykatës që të braktisë rolin e saj si e paanshme dhe të ndërtojë vetë sipas bindjes së saj subjektive kërkimet e paditësit.

22. Kolegji, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, si edhe referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore bashkëlidhur ankimit kushtetues, vëren se kërkuesi ka ushtruar lirisht të drejtën e ngritjes së padisë, sikurse edhe të drejtën e ankimit e rekursit, dhe gjykatat e vëna në lëvizje prej tij kanë analizuar themelin e çështjes, duke u përmbyllur me vendimin e Gjykatës së Lartë, që i ka dhënë përgjigje të arsyetuar shkaqeve të parashtruara prej tij para saj. Nga ana tjetër, vendimi i Gjykatës së Lartë i marrë në dhomën e këshillimit ka pasqyruar në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, arsyetimin e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekursit e palëve ndërgjyqëse, ligjin e zbatueshëm, si dhe analizën e dispozitave të zbatueshme ku është mbështetur qëndrimi i shprehur në dispozitivin e saj. Po kështu, pjesët e vendimit dhe arsyetimi i përdorur nga Gjykata e Lartë tregojnë mjaftueshëm se palët ndërgjyqëse janë dëgjuar për mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi. Për më tepër, Kolegji vëren se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij janë atribut

kushtetues i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

23. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.